



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:252068
Datë: 04.06.2024
Numri i dokumentit: 05779802

KPPP.nr. 1916/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit KRM “Eko Regjioni” Sh.A., me numër të biznesit 70465066 dhe me seli në Rahovec, Njësia Operative, kundër debitorit N.P.T “Visari”, me numër unik identifikues 810388240 dhe seli në Rahovec, rr. “Xhelal Hajda Toni”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 719/23 të datës 03.11.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 04.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.P.T “Visari”, me seli në Rahovec ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 719/23 i datës 03.11.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KRM “Eko Regjioni” Sh.A., me datë 03.11.2023 ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 719/23 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Ekstraktit nga librat e kontabilitetit me shifrën L0041513, ashtu që është detyruar debitori që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, në emër të borxhit të papaguar, t’ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 309.92 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi për përbarim.

Debitori, brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përbarimit me arsyetim se në mes të kreditorit dhe debitorit nuk është nënshkruar kontrata për shërbime, andaj edhe borxhi i kërkuar përmes propozimit për përbarim është pa bazë ligjore. Ka shtuar se është

parashkruar kërkesa, duke qenë se vlen afati 1 vjeçar i parashkrimit, sipas nenit 360 të LMD-së. Duke qenë se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa propozimi për përmbartim të hudhet si i pa bazuar.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se prapësimin e ka paraqitur duke mos u bazuar në asnjërën nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi. Ka shtuar se urdhri përmbartimor është lejuar duke u bazuar në dokument të besueshëm, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejme: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar* “.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se ekstrakti nga librat afarist me shifër L0041513, mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së, ngase në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit.

Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që në propozimin për përmbartim, kreditori ka kërkuar realizimin e borxhit nga muaji tetor 2018 e deri në muajin shtator 2023, por që ekstrakti nga librat afarist përmban përmbledhjen e faturave vetëm nga data 01.01.2019. Në ndërlidhje me këtë, në ekstraktin e lartcekur, si borxh i bartur figuron shuma prej 1,067.36 EUR por që kjo lartësi e borxhit nuk dihet se për cilën periudhë kohore është grumbulluar, pasi që propozimit

për përbarim nuk i janë bashkangjitur ekstraktet që përmbajnë faturat edhe për këtë pjesë të borxhit.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Meqenëse dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi nuk ka tipare të përbarueshmërisë për shkak të të metave në objektin e detyrimit të saj, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga debitori si në prapësim, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1916/23, datë 04.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.